

Date:19.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Shtrim Linje KUZ në zonën e shkollës Gjergj Kastrioti lagja nr.1 ,Durrës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimi 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,966,955.29 (Dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë presje njëzet e nëntë) leke pa tvsh, vene ne dispozicion nga Buxheti i Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizme Durres.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: Afati i kryerjes së punimeve është 4 (kater) jave sipas Grafikut të Punimeve

ARGUMENTIMI:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Shoqëria Rajonale Ujësajelles Kanalizime Durres Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 dhe 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe në nenin 39, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

*Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenet 43 dhe të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar: “1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, gjithashtu, bazuar dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29. 12. 2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen që ka në këtë bashkim operatorësh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për kështet e maturuara të vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30.10. 2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe nenin 40 në Ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për QKR” i ndryshuar.

AFTËSITË TEKNIKE DHE PROFESIONALE:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

-Formular vleresimit (sipas shtojcës 9).

-Kontratën/at e Sipërmarrjes;

-Situacionin përfundimtar të objektit;

-Akt-kolaudimi

-Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

-Kontratën/at e Sipërmarrjes;

-Situacionin përfundimtar të objektit;

-Akt-kolaudimin,

-Çertifikatën e marrjes ne dorezim,

-Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontratën e

bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. ”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktës dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria NP- 1 (Punime germimi ne toke)	Klasifikimi A
Kategoria NP- 4 (Rruge, autostrada, mbikalime)	Klasifikimi A
Kategoria NP- 7 (Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje)	Klasifikimi A
Kategoria NP-12 (Punime te inxhinierise mjedisore)	Klasifikimi A
Kategoria NS-18 (Punime topogjeodezike)	Klasifikimi A

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16. 01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë e vendosura sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16. 1. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për dy muajt e fundit mesatarisht të paktën 19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

-Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.

-Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar

duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit të kontratës, orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për të paktën dy muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listë-pagesat me këtë kohështirje, është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10. 09. 1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe në zbatim të akteve nënligjore. Nga ana teknike argumentojmë se numri prej 19 punonjës në total (ku janë përfshirë Drejtorët Teknikë, Ing. Mbështetës, punonjësit e specialiteteve të ndryshme për punimet përkatëse, shoferë, manovratorë), është caktuar në bazë të llogaritjeve (zbërthimit) të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në analizat teknike si dhe grafikut në zbatimin të punimeve. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë afatin e zbatimit në grafikun e punimeve si dhe orët total të punës për secilin zë punimesh në kontratës që prokurohet. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhënë garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listë-pagesat e punonjësve, mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19 .05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, si mëposhtë:

- | | |
|---|---------|
| ➤ Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Ndërtimi/Transporti | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Mjedisi-Trajtim ujra | 1 (një) |
| ➤ Inxhinier Gjeodet/Topograf/Marshajder | 1 (një) |

OE duhet te paraqesin:

-Kontratë pune e vlefshme

-Diplomë profesionale

Shënim: Ky kriter përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të projektit të zbatimit të punimeve.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit në proceset e punës. Ky inxhinier ka për detyrë menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit;

Inxhinieri i Mjedisit është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha punimeve dhe sigurimin që punimet e kryera, të mos cenojnë kushtet dhe parametrat mjedisorë të terrenit, dhe të kenë ndikim sa më të vogël në mjedis.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar zërave hidroteknike dhe instalimeve”, etj. Ky inxhinier është përgjegjës për shtrimin e linjave të ujësjellësit, vendosjen e matësve të ujit të pijshëm, rakorderive, etj., ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit;

Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder është përgjegjës për kryerjen e azhornimit topografik dhe piketimin e objektit, si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhornimin faktit. Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien dhe vendosjen në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore, gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Hidraulik (termohidraulik) 1 (nje) punonjes
- teknik Mekanik 1 (nje) punonjes
- Karpertier 1 (nje) punonjes
- Hekurkthyes 1 (nje) punonjes
- Betonues 1 (nje) punonjes
- Drejtues mjete 2 (dy) punonjes
- Eskavatoriste 1 (nje) punonjes
- Automakinist 1 (nje) punonjes
- Punetor Krahu 6 (nje) punonjes

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

-kontratën individuale të punës;

-një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

-Certifikat te sigurimit teknik te lëshuar nga subjekte te akredituara nga DPA ose organizata ekuivalent nderkombetare te njohura nga Rep.Shqiperise.

-Per punonjesit drejtues mjete dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten deshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certifikate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.

Shënim: Ky kriter përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit

Argumentimi: vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Teknik Hidraulik (Termohidraulik)- Ky pozicion është i nevojshëm për realizimin e punimeve hidraulike që lidhen me shtrimin dhe funksionalizimin e linjës së KUZ. Tekniku hidraulik siguron montimin, lidhjen, kontrollin dhe sistemimin teknik të tubacioneve, pusetave dhe elementeve të tjera të rrjetit, duke garantuar që punimet të kryhen sipas kërkesave teknike dhe me funksionim të rregullt të sistemit të kanalizimeve.

Teknik Mekanik - Nevoja për teknik mekanik lidhet me përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive që do të angazhohen gjatë zbatimit të punimeve. Ai garanton kontrollin teknik të mjeteve/pajisjeve mekanike, ndërhyrjen në rast defektesh dhe funksionimin e tyre në kushte të përshtatshme pune, duke shmangur ndërprerjet dhe vonesat në realizimin e objektit

Karpentier – Karpentieri është i nevojshëm për realizimin e punimeve të formimit dhe mbështetjes së elementeve të përkohshme apo të përhershme prej druri, kallëpeve dhe strukturave ndihmëse që mund të nevojiten gjatë punimeve. Prania e tij siguron realizimin korrekt të këtyre proceseve dhe përgatitjen e elementeve sipas dimensioneve dhe kërkesave të projektit.

Hekurkthyes – Hekurkthyesi nevojitet për prerjen, përkuljen, përgatitjen dhe vendosjen e armaturës së çelikut në elementët prej betoni të parashikuar në objekt. Ky është një proces teknik që kërkon punonjës të kualifikuar, pasi përpunimi dhe vendosja e armaturës duhet të bëhen në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike, për të garantuar qëndrueshmërinë e elementeve konstruktive.

Betonues – Punonjësi betonues është i nevojshëm për përgatitjen, hedhjen, shpërndarjen dhe përfundimin e punimeve të betonit që mund të përfshihen në realizimin e pusetave, bazamenteve, kapakëve, rikonstruksioneve dhe elementeve të tjera të rrjetit. Kualifikimi i tij ndihmon në garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së punimeve të betonit.

Drejtues mjeti – Kërkesa për dy drejtues mjeti justifikohet nga nevoja për transportimin e materialeve të ndërtimit, tubacioneve, dherave, inerteve dhe materialeve të tjera që dalin gjatë gërmimeve dhe punimeve. Numri prej dy punonjësish lidhet me nevojën për të siguruar vijimësinë e transportit dhe furnizimit të kantierit, duke shmangur ndërprerjet e punimeve.

Eskavatorist – Eskavatoristi është thelbësor për këtë objekt, pasi shtrimi i linjës së KUZ kërkon kryerjen e gërmimeve për hapjen e trasese, krijimin e kanaleve me dimensionet e përcaktuara, largimin e materialit të gërmuar dhe, sipas nevojës, mbushjen dhe sistemimin e tyre. Operimi i eskavatorit kërkon personel të kualifikuar për të garantuar saktësinë e gërmimeve dhe sigurinë në kantier.

Automakinist – Automakinisti nevojitet për operimin e mjeteve dhe makinerive të rënda që përdoren në proceset e ndërtimit dhe sistemimit të zonës së punimeve. Angazhimi i një punonjësi të specializuar garanton përdorimin korrekt të makinerive, rrit sigurinë në kantier dhe ndihmon në realizimin me efikasitet të punimeve.

Punëtor krahu –Punëtorë krahu justifikohet nga natyra intensive e punimeve të shtrimit të linjës së KUZ. Ata janë të nevojshëm për procese ndihmëse si pastrimi dhe sistemimi i trasese, përgatitja e zonës së punës, asistimi në vendosjen e tubacioneve, punimet rreth pusetave, ngarkimin/shkarkimin dhe sistemimin e materialeve, mbushjet dhe punime të tjera manuale. Numri i tyre lidhet me nevojën për të zhvilluar paralelisht disa procese pune dhe për të siguruar ritmin e parashikuar të realizimit të objektit.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

-SSH/EN-ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent

-SSH/EN-ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent

-SSH/EN-ISO 45001:2018 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Nese certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23.12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

SSH/EN-ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO

9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

SSH/EN-ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit,

SSH/EN-ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Kamion Autovinc veteshkarkues me kapacitet mbajtes 5 ton	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes 05 -1.5 ton	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 -5 ton	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
4	Makineri per çbllokim rruge, me goma me kove para -mbrapa (mjet teknologjik) me targa	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
5	Rul Asfalti 4-6 ton	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope

6	Mjet teknologjik -Pirun teleskopik-manitu (mjet teknologjik)	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
7	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbartes 10-14 ton	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
8	Minifadrome (mjet teknologjik) me targa	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
9	Miniekskavator me zinxhire	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
10	Freze prerese Asfalti	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
11	Dedektor rrjetesh nentoksore me GPRS	Ne pronesi ose me qira	1(nje) cope
PAJISJE MBROJTESE			
Kokore minimumi		20 copë	
Jeleke fosforoshente minimumi		20 copë	
Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi		2 cope	
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi		10 cope	
Prozhektorë ndriçimi natën minimumi		3 cope	
Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi		2 cope	

Për makineri dhe mjete që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të

paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracionin;

Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;

Për makineri dhe mjete që nuk shënohen në regjistra publikë (makineritë), kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse.

Ndërsa për makineri dhe mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë (bashkëngjitur faturë zhdoganimit ose faturë tatimore blerje) dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;

Për paisjet kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontratë blerje/faturë zhdoganimit/faturë tatimore blerje..

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilën makineri dhe mjete dhe paisje të deklaruar.

Për makineritë dhe mjetet, fotoja duhet të kete të dallueshme edhe targën e mjetit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fitues.

Shenim: Per mjetin "Rimorkiator per transportin e makinerive", ne rast se nga Operatori Ekonomik nuk disponohet dokumentacioni çertifikate pronesie / kontrate qeraje, nga autoriteti kontraktor do te pranohet edhe dokumenti kontrate huaperdorje.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...", sjellim ne vemendje se:

Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.

Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit per disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do te jete kusht s'kualifikimi.

Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të

nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi /qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe volumeve të punës në projekt, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve	Proceset sipas preventivit	Sasia
1	Kamion Autovinc veteshkarkues me kapacitet mbajtes 5 ton	Transport në kantier dhe largim i materialeve të dala nga gërmimet/prishjet; transport i tubacioneve, inerteve, materialeve dhe pajisjeve të punës; furnizim i kantierit me materiale gjatë zbatimit të punimeve.	copë 1
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes 05 -1.5 ton	Transport i materialeve të vogla të ndërtimit, veglave dhe pajisjeve të punës; transport i materialeve të nevojshme për punimet e linjës KUZ dhe furnizim i vazhdueshëm i frontit të punimeve.	copë 1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 -5 ton	Transport dhe largim i materialeve të dala nga gërmimet dhe prishjet; transport i tubacioneve, inerteve, materialeve dhe pajisjeve të punës nga/në kantier.	copë 1
4	Makineri për çbllokim rruge, me goma me kove para -mbrapa (mjet teknologjik) me targa	Gërmime dheu për hapjen e kanalit të linjës KUZ; ngarkim dhe sistemim i materialit të gërmuar; mbushje dhe sistemim i trasese pas vendosjes së tubacioneve; nivelim dhe pastrim i zonës së punimeve.	copë 1
5	Rul Asfalti 4-6 ton	Ngjeshje dhe kompaktim i shtresave të mbushjes pas përfundimit të punimeve të kanalizimit; sistemim dhe rikthim i sipërfaqeve të rrugës pas mbylljes së kanalit.	copë 1

6	Mjet teknologjik -Pirun teleskopik-manitu (mjet teknologjik)	Ngritje, ngarkim, shkarkim dhe pozicionim i tubacioneve, materialeve, elementeve të pusetave dhe materialeve të tjera të ndërtimit në zonën e punimeve	copë 1
7	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbartes 10-14 ton	Transport dhe largim i sasive të mëdha të materialeve të gërmuara; transport i inerteve dhe materialeve të mbushjes; furnizim i kantierit me materiale ndërtimi.	copë 1
8	Minifadrome (mjet teknologjik) me targa	Transport dhe shpërndarje në distanca të shkurtra e materialeve, inerteve dhe materialeve të gërmuara brenda kantierit; asistim në mbushjen dhe sistemimin e trasese së linjës KUZ	copë 1
9	Miniekskavator me zinxhire	Gërmim i kanalit për shtrimin e tubacionit të KUZ; gërmime pranë pusetave dhe lidhjeve; ngarkim i materialit të gërmuar; punime në zona të kufizuara dhe pranë objekteve ekzistuese; nivelim dhe sistemim i kanalit.	copë 1
10	Freze Asfalti	Prerje dhe heqje e shtresës ekzistuese të asfaltit në zonat ku do të hapet trasa e linjës KUZ; përgatitje e sipërfaqes për gërmime dhe për rikthimin e shtresës rrugore pas përfundimit të punimeve.	copë 1
11	Dedektor rrjetesh nentoksore me GPRS	Identifikim, lokalizim dhe evidentim i rrjeteve ekzistuese nëntokësore përpara dhe gjatë gërmimeve; përcaktim i pozicionit të linjave ekzistuese të ujësjellësit, kanalizimeve, energjisë, telekomunikacionit etj.; shmangie e dëmtimit të rrjeteve ekzistuese gjatë hapjes së trasese.	copë 1

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga grupi I punes. Njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike për punimet objekt prokurimi.

Kudo tek specifikimet apo relacionet teknike bashkelidhur ne SPE ku jane kerkuar standartet UNI/DIN/EN/ISO do te pranohen edhe standartet SSH/ UNI/DIN/EN/ISO.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim“,

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.